

STATUTI I SHOQËRISE ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR "CRADLE OF WINE" sh.p.k

Sot më datë 18/02/2024, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil, në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe në ligjin Nr. 9723, datë 3.05.2007 "Per Qendren Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, Z. Elio Devole, lindur me datë 26/04/1998, në Tiranë, shtetas Shqiptar, identifikuar me Pasaportë me Nr. Personal J80426058F, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, dhe Z. Erti Likaj, lindur me datë 11/12/1997, në Tiranë, shtetas Shqiptar, identifikuar me Pasaportë me Nr. Personal J71211041A, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, nënshkruajnë Aktin e Themelimit (të inkorporuar në këtë Statut) me qellim themelin e kësaj shoqërie sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

KREU I - EMRI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHEZGJATJA DHE KAPITALI THEMELTAR

NENI I - Emri i Shoqërisë

1.1. Emri i shoqërisë, në përputhje me kriteret ligjore të Republikës së Shqipërisë, është "CRADLE OF WINE" sh.p.k.

NENI II - Forma Ligjore

2.1. Shoqëria "CRADLE OF WINE" sh.p.k (këtu e në vijim referuar si "Shoqëria") është e themeluar dhe organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet nga ky Statut dhe ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

2.2. Shoqëria do të operojë në përputhje të plotë me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

NENI III - Objekti i Veprimtarisë

3.1. Mbështetur në nenin 7 të ligjit Nr. 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare me objekt: "Import eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të pijeve alkoolike dhe jo alkoolike, si edhe produkteve të ndryshme ushqimore"

3.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI IV - Selia

- 4.1. Selia e shoqërisë, në përbushje të aktivitetit të saj tregtar, është në adresën Rr. Muhamet Gjollesha P.53-2, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2. Vendimi për transferimin e selisë së shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3. Çelja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit në qytete të tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të caktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI V - Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqëria do të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar.

NENI VI - Kapitali Themeltar dhe Kuotat e Shoqerise

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 Leke.
- 6.2. Numri total i kuotave do të jetë 2 (dy) me vlerë nominale 50 Leke për kuotë.
- 6.3 Ortaket e shoqërisë janë dy dhe paraqiten si më poshtë:
 1. z. Elio Devole, lindur në Tiranë më 26/04/1998, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal J80426058F, zotërues i kuotës me vlerë nominale 50 Lekë zotëron 50 përqind të së drejtës së votës në shoqëri.
 2. z. Erti Likaj, lindur në Tiranë më 11/12/1997, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal J71211041A, zotërues i kuotës me vlerë nominale 50 Lekë zotëron 50 përqind të së drejtës së votës në shoqëri.
- 6.3. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë dhe/ose zvogelojë Kapitalin Themeltar në çdo moment nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, deri në kufirin minimal të parashikuar nga ligji në fuqi, të konsideruar si i nevojshëm për të realizuar qëllimin e themelimit të shoqërisë. Nëse shoqëria do të mbetet vetëm me një Ortak, atëherë Ortaku i vetëm do të ushtrojë kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme.
- 6.4. Shoqeria mund të emetojë kuota në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.
- 6.5. Procedura për zmadhimin dhe/ose zvogelin e kapitalit themeltar do të rregullohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme rast pas rasti.
- 6.6. Kuota e kapitalit të shoqërisë e të drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:



- a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b. Shtiblerjes;
- c. Trashigimisë;
- d. Dhurimit;
- e. Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj;

6.7. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit do të rregullohen nga kontrata.

6.8. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyre solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotes, nga rasti i kalimit të kuotave, deri në rastin e regjistrimit të kalimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni VII - Zmadhimi i Kapitalit

7.1. Ortakët mund të zmadhojnë kontributin e tyre në kuotat e kapitalit të Shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet duke iu ofruar për nënshkrim kuota të reja ortakeve ekzistues të Shoqërisë në proporcion me përqindjet e tyre në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë ose nëpërmjet zmadhimit të vlerës nominale të kuotave ekzistuese. Kontributet mund të janë në para ose ne çdo lloj forme të parashikuar nga ligji, duke përfshirë kontribute në natyrë.

7.2. Mënyra e zmadhimit të kapitalit (nënshkrimi i kuotave të reja apo zmadhimi i vlerës nominale) në lidhje me metodat dhe afatet e pagimit të kontributeve nga ortaket do të vendoset rast pas rasti me vendim të Asamblesë së Ortakeve të marrë me Shumicë të Cilesuar. Vendimet e Asamblesë së Ortakeve mund të përfshijnë ndër të tjera dënimet dhe pasojat për një ortak në rast të mos-pagesës së kontributit të rënë dakord në afatin dhe shumën e caktuar duke përfshirë, po pa u kufizuar:

- (i) zvogëlimin proporcional të pjesës së ortakut në Shoqëri
- (ii) shitjen e detyruar të kuotave të ortakut në Shoqëri
- (iii) interesa për pagesë të vonuar, etj.

7.3. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes se kuotave të reja nga ortakë të rinj. Ortakë të rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Ortakëve me Shumicë të Cilësuar.

7.4. Ortaket kanë vendosur që kur rritja e kapitalit është e nevojshme, Shoqëria të mbulojë të gjithë detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 6 ose 12 muajve në vazhdim. Ortaket e pranishëm në asamble do të votojnë në favor të zmadhimit të kapitalit, edhe nëse nuk janë personalisht në gjendje të kontribuojnë në kete zmadhim brenda një afati jo më të gjatë se 30 ditë që prej dates se mbledhjes se Asamblese se Ortakeve që vendosin per zmadhimin e kapitalit. Në këtë rast, kuota e tyre në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë pas zmadhimit, do te zvogëlohet në favor të ortakëve që do të

kontribuojnë. Nëse ndonjë prej ortakeve nuk e respekton marrëveshjen e këtij nenit, secili prej ortakëve ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës zbatimin e detyrimit të Ortakëve që dështojnë në zbatimin e këtij nenit 7.4.

NENI VIII - Zvogëlimi i Kapitalit

8.1. Bazuar në vendimet e Asamblesë së Ortakëve, zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga Ligji i Shoqërive Tregtare.

KREU II - ORGANET E SHOQËRISË

NENI IX - Asambleja e Përgjithshme

9.1. Asambleja e Përgjithshme vepron në mbeshtetje të parashikimeve ligjore dhe dakortësimeve mes ortakëve të shoqërisë dhe është kompetente për cështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e Statutit të shoqërisë;
- c) Zmadhimin dhe/ose Zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/Administratorëve, likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorin, Likuiduesit dhe Ekspertët Kontabël të autorizuar;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori dhe/ose administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/administratorëve të shoqërisë;
- i) Blerjen, Bashkimin, Shkrirjen, Transformimin dhe procesin e Likuidimit të shoqërisë;
- j) Emetimi i kuotave;
- k) Përcaktimin e pages, bonuseve si dhe kohëzgjatjen e emërit të Administratorit.
- l) Kërkesën drejtuar Administratorit të Shoqërisë për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë rast pas rasti;
- m) Çështje të tjera në ngarkim të Asamblesë nga ligji dhe ky Statut;
- n) Asambleja e Përgjithshme vlerëson dhe vendos për cështjet e parashikuara në nenin 17 të ligjit për shoqëritë tregtare (ndalimi i konkurrencës) rast pas rasti.

9.2. Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve ("Asambleja e Përgjithshme"), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për

të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e tjera të siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e ligjit për Shoqerite Tregtare.

NENI X - Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

10.1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori nëpërmjet njoftimit me poste, njoftimit me poste elektronike ose me cdo mënyrë tjetër që mund të percillet informacioni, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

10.2. Asambleja e Ortakeve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë të pakten një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të cdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.

10.3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së parashikuar më sipër, vendimet e Asamblesë konsiderohen të vlefshme vetem nëse të gjithë ortaket janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

10.4. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi (vetëm për atë mbledhje) nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

10.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Administratori i shoqërisë duke përcaktuar rendin e ditës sipas nevojave dhe interesave të shoqërisë, të pakten 1 herë në vit.

10.6. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqerise nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

10.7. Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

10.8. Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve të para të regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

10.9. Ortaku është personalisht përgjegjës për njofimin e të gjitha të dhënavë të kontaktit përfshirë por jo vetëm adresën postare, numrin e faksit, adresën e postës elektronike, tek Administratori i Shoqerisë dhe gjithashtu të njoftojë Administratorin për cdo ndryshim të njëpasnjëshëm të të dhënavë të tyre të kontaktit. Adresa e Administratorit do të konsiderohet selia e Shoqerisë por administratori është gjithashtu i detyruar të japë informacion të kontaktit të tij/saj personal tek ortaku.

NENI XI - Kuorumi dhe Vendimarrja në Asamblenë e Përgjithshme

11.1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme 50+1 përqind, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

11.2. Për cështjet që kërkojnë shumicë të kualifikuar si ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, asambleja vendos me tri të katërtat e ortakeve pjesëmarrës vetëm nëse ortaket që zoterojnë më shumë se gjysma e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

11.3. Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në këtë statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkates.

11.4. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal, të mbajtur nga Administratori i shoqërisë. Prosesverbalit përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

11.5. Nëse Asambleja e Ortakeve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërisht në përputhje me parashikimet e Nenit X por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.

11.6. Ortakët njohin dhe pranojnë të drejtën për të vendosur në lidhje me Shoqërinë me shkrim. Vendimet e propozuara, së bashku me dokumentet që mbështesin vendimet do t'i dërgohen ortakëve nga Administratori në përputhje me nenin X. Ortakët do te vendosin mbi vendimet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentit i cili përmban tekstin e vendimeve, duke kthyer brenda kësaj periudhe një kopje origjinale të nënshkruar te Administratori i Shoqërisë dhe gjithashtu me poste elektronike, një kopje elektronike të saj. Ortakët që kanë kundërshtuar do tu jepet mundësia të shprehin kundershtimin e tyre në lidhje me vendimin me shkrim, në dokumentin që përmban tekstin e vendimeve të propozuara. Vendimet me shkrim do të konsiderohen të miratuara nëqoftëse miratohen nga shumica e kërkuar dhe kuorumi. Për këtë qellim, të gjithë ortakët mund të nënshkruajnë kopje të veçanta por të njejta të dokumentit që përmban tekstin e vendimeve të propozuara.

NENI XII - E drejta e votës dhe çështje të lidhura me të

12.1. Cdo ortak i shoqërisë ka të drejtën e votës.

12.2. Ortaket e shoqërisë janë si me poshtë:

1. z. Elio Devole, lindur në Tiranë më 26/04/1998, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal J80426058F, zotërues i kuotës me vlere nominale 50 Lekë zoteron 50 përqind të së drejtës së votës në shoqëri.

2. z. Erti Likaj, lindur në Tiranë më 11/12/1997, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal J71211041A, zotërues i kuotës me vlere nominale 50 Lekë zotëron 50 përqind të së drejtës së votës në shoqëri.

12.3. Ortaku perjashtohet nga e drejta e votës vetëm në rastet kur asambleja voton mbi:

- a. Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b. Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c. Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d. Dhënien ose jo të përfitimeve të reja;
- e. Situatat e tjera të parashikuara me ligj;

12.4. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vleresohej të jetë në të njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni XIII - Doreheqja e Ortakut

13.1. Dorëheqja e ortakut rregullohet nga Neni 101 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

13.2. Ortaku i cili ka qellim të heqë dorë nga Shoqëria duhet t'i japë njoftim me shkrim Administratorit per qellimin/shkakun e tij për të hequr dorë nga anëtarësimi në Shoqëri dhe arsyet e kësaj heqje dore.

13.3. Administratori menjeherë pas marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin 2 të këtij Neni, do të thërrasë Asamblenë e Ortakëve në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Statut dhe ligjin për shoqëritë tregtare për të vendosur nëse ortaku do të marrë pagesën e kuotave te tij për shkak të dorëheqjes së tij të vlefshme.

13.4. Asambleja e Ortakëve do të diskutojë arsyet e dorëheqjes të paraqitura nga ortaku dhe do të vendosë nëse ketë arsyet janë të vlefshme dhe shumën si edhe mënyren e shlyerjes së kuotave të ortakut që jep dorëheqjen. Ortaku që jep dorëheqjen mund të nise procedurat përpëra gjykatës kompetente duke i kerkuar Shoqërisë shlyerjen e kuotave të tij për shkak te doreheqjes se tij të rregullt në rast se Administratori nuk mbledh Asamblenë e Ortakëve ose ky i fundit nuk i njeh arsyet e ortakut për dorëheqje dhe të drejtën e shlyerjes.

13.5. Nëse Asambleja e Ortakeve nuk mblidhet për shkak të vullnetit ose mungesës së kuorumin ose nëse nuk miraton arsyet e dorëheqjes si te vlefshme pra duke mohuar të drejtën e shlyerjes për ortakun që jep dorëheqjen brenda një periudhe prej 60 ditesh nga data që Administratori ka marrë njoftimin e qellimit të dorëheqjes, ortaku që jep dorëheqjen mund:

- a) Të ushtrojë të drejtën e dorëheqjes duke njoftuar Administratorin e Shoqërisë në selinë e tij duke dërguar një njoftim me shkrim brenda një periudhe prej 30 ditësh pas përfundimit të afatit të përmendur në Nenin 13.5 më sipër. Në këtë rast dorëheqja do të konsiderohet e zbatueshme nga data e marrjes së këtij njoftimi me shkrim dhe Administratori do të marrë

të gjitha masat për të regjistruar këtë dorëheqje në Qendren Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ligjin;

Ose

- b) Të nisë procedurat pranë gjykatës kompetente në përputhje me Nenin 13.5, rast në të cilin dorëheqja do të konsiderohet e zbatueshme nga data e lëshimit të vendimit perfundimtar te gjykatës për këtë qellim.

NENI XIV - Administratori

14.1. Shoqëria tregtare "CRADLE OF WINE" sh.p.k do të përfaqësohet në marrëdhenie me të tretet nga administratori i saj, i cili vepron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, në përputhje me këtë statut dhe ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Administrator i shoqerisë "CRADLE OF WINE" sh.p.k emërohet Z. Elio Devole, i biri i Lorenc lindur me date 26/04/1998, në Tiranë dhe banues ne Rr. "Muhamet Gjollesha", P.53-2 Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me mjet identifikimi leternjoftim me Nr. J80426058F **për një periudhë 3 vjecare, duke filluar nga data 19/02/2024.**

14.2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë administrator i një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bërë në kundershtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

14.3. Administratori kryen detyrat e tij në përputhje me parashikimet ligjore të detyrimit të besnikërisë sipas neneve 12 (Perfaqësimi), 14 (Besnikëri ndaj shoqërisë), 15 (Informimi për ortakët e shoqërisë sipas parashikimeve ligjore), 17 (Ndalimi i Konkurrencës) e 18 (Sekreti Tregtar) të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI XV - Detyrat dhe përgjegjësitet e Administratorit

15.1. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për:

- Manazhimin e veprimtarisë së biznesit me implementimin e politikave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- Përfaqësimin e shoqërisë tregtare;
- Kujdesjen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin vjetor të përformancës së shoqërisë. Paraqitjen e dokumenteve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për miratim së bashku me propozimin dhe shprndarjen e fitimeve;
- Krijimin e një sistemi paralajmërues për zhvillimet që mund të cenojnë shoqërinë;

g) Raportimin në Asamblenë e Përgjithshme mbi implementimin e politikave të të bërit biznes dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të vecantë për performancën e shoqërisë;

h) Te therritur Asamblenë e Ortakeve, kurdo që e konsideron të nevojshëm për interesat e Shoqërisë dhe të ndërmarrë të gjitha formalitetet për thirrjen e rregullt të mbledhjes;

i) Kryerjen e detyrave të parashikuara nga ligji ose Statuti;

15.2. Administratori mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera tregtare, nëse deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyren e objektin e interesit të tij e veprimi autorizohet paraprakisht nga të gjithë ortakët e shoqërisë. Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

15.3. Administratori mund të autorizoje palë të treta për kryerjen e veprimeve të ndryshme, të tilla si: depozitim i Pasqyrave Financiare në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përfaqësimin e shoqërisë para institucioneve shtetërore etj., përpara organeve gjyqësore, përvec rasteve të parashikuara si kompetence ekskluzive e Administratorit nga ligji ose ky Statut.

15.4. Administratori i shoqërisë mund të veprojë në kundershtim me parimin e ndalimit të konkurrences, vetëm me autorizimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme, parashikuar në ligjin për tregtaret dhe shoqeritë tregtare. Çdo veprim në kundërshtim me këtë parashikim është i pavlefshëm e për pasoje nuk sjell efekte juridike.

15.5. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, qe jep doreheqjen, duke pasur parasysh rrëthanat e veprimtarisë së shoqërisë, eshtë gjithashtu i detyruar të therrasë asamblenë e përgjithshme për emerimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyje në fuqi.

15.6. Shpërblimi i administratorit përcaktohet me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtësa, që mund të janë në përqindje të fitimit ose të ngjashme. Shpërblimet do të janë në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

15.7. Administratori i shoqerise i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjesitë e tij, të parashikuara në ketë statut apo në ligjin për tregtarët dhe shoqeritë tregtare, me profesionalizëm dhe mënjanon në çdo rast konfliktin e interesit në procesin e administrimit të shoqerisë.

15.8. Në ushtrimin e detyrës së tij, administratori udhëhiqet në interes të lartë të shoqerisë edhe në rastet kur një ortak i shoqërisë kerkon ndryshe, qoftë ky ortak në shumicë apo në pakice.

NENI XVI - Detyrimi i besnikerisë dhe përgjegjesitë

16.1 Përveç detyrimeve të përgjithshme të parimit të besnikerisë së parashikuar në Nenet 14,15,17 dhc 18 të ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori duhet:



- a) të kryeje detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Shoqeritë Tregtare apo këtë Statut në mirëbesim dhe duke marrë parasysh interesat e Shoqerisë si e tërë, dhe në vecanti duke konsideruar ndikimin në mjeshtërisht veprintar;
- b) të ushtrojë kompetencat e tij të caktuara prej ligjit për Shoqeritë Tregtare apo këtij Statuti, vetëm për qellimet e paracaktuara aty;
- c) të konsiderojë në menyrë të përshtatshme cështjet për të cilat duhet të vendosë;
- d) të parandalojë dhe të shmange konflikte potenciale ndermjet personave të interesuar dhe Shoqerisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij sipas parimit të kujdesit dhe të profesionalizmit;
- f) të vendosë në dispozicion cdo informacion në lidhje me biznesin dhe të dhëna ekonomike të Shoqerisë të kerkuara nga secili prej ortakeve, brenda një afati kohor të përshtatshëm dhe në cdo rast jo me vonë se 30 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhen përditësuar.

16.2. Administratori i shoqerisë, gjatë ushtrimit të profesionit të tij, do të jetë përgjegjes ndaj Shoqerisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në menyrë të arsyeshme me qellimet e Shoqerisë, me përjashtim të rastëve kur, në baze të hetimit dhe vleresimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është ushtruar në mirëbesim.

16.3. Në rast shkeljeje të detyrave dhe të standardeve profesionale të parashikuara në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni, Administratori ka detyrimin të dëmshpërblejë Shoqërinë për çdo dem që rezulton nga këto shkelje. Ai gjithashtu duhet të dorezojë çdo fitim përsosur nga ai apo përsosur të lidhur gjatë shkeljes së detyrimeve të tij. Ai do të ketë barrën e provës për të provuar përputhshmërinë e ushtrimit të detyrave të tij me standartet e kerkuara.

16.4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundershtim me dispozitat e ketij ligji, kryen veprimet e mëposhtme :

- a) u kthen anëtarëve kontributët;
- b) u paguan anëtarëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

KREU III - EKSPËRTI KONTABEL, DIVIDENDI, PRISHJA, LIKUIDIMI, TË NDRYSHME

NENI XVII - Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar

17.1. Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakeve, nëse është e nevojshme. Eksperti(ët) Kontabël të autorizuar do të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me normat ligjore në fuqi në Republiken e Shqipërisë.

NENI XVIII - Dividendet dhe Fitimi

18.1. Ortaku(ët) kanë të drejtën e ndarjes së fitimeve të paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë, të cilat do t'i shpërndahen në raport me kuotat e tyre, në përputhje me dispozitat e Nenit 77 të Ligjit për Shoqeritë Tregtare.

18.2. Dividendi do të shpërndahet cdo fundviti financier përvèc se kur Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar për të investuar në shoqëri. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk ka marre vendim deri me datë 31 Maj të vitit pasardhës, Dividendi do t'u shpërndahet ortakeve dhe Administratori mund të shpërndaje Certifikatën e aftësisë paguese sipas nënëtit 77 të ligjit për tregtarët dhe shoqeritë tregtare.

NENI XIX - Viti Financiar

19.1. Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.


NENI XX - Bilanci dhe Mbajtja e Llogarisë

20.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.

20.2. Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.

NENI XXI - Prishja e Shoqërisë

21.1. Shoqëria mbaron me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me celjen e procedurës së falimentit, nëse nuk ka kryer veprimtari biznesi për 2 (dy) vjet dhe nuk ka njofuar me parë statusin inaktiv sipas ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", ose me vendim gjyqësor.



21.2. Administratori ose çdo person i autorizuar prej tij do të depozitojë reportin e mbarimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me ligjin 9723 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

NENI XXII - Likuidimi

22.1 Pas vendimit për mbarimin e shoqerisë, do të çelet procedura e likuidimit, përvec rastëve kur ka filluar një procedurë falimenti.

22.2. Për kryerjen e procesit të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron (një) ose disa likuidues, për qellim hartimin e raportit të aktiveve dhe detyrimeve të shoqerisë, deri në mbarim të procesit të likuidimit.

22.3. Proçesi i likuidimit do të behet në përputhje me ligjin 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

22.4. Pas pagesës së likuiduesve, kapitali i mbetur i shoqërisë do t'i shpërndahet Ortakëve të Shoqerisë.

NENI XXIII - Të ndryshme

23.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

23.2 Të gjitha situatat që nuk parashikohen nga ky Statut do të rregullohen nga ligji shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

23.3. Të gjithë dokumentët për palët e treta, të tillë si njoftime, publikime, dhe faturime etj., do të përfshijnë emrin e shoqerisë, sëbashku me shkurtimet "sh.p.k.", selinë, emrin e administratorit ose të autorizuarit prej tij.

23.4. Bazuar në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në Regjistrin e mbajtur për këtë qëllim.

23.5. Ky statut është I draftuar në 4 (katër) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike.

23.6. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

"CRADLE OF WINE" sh.p.k

Z. Elio DEVOLË

(në cilësinë e Administratorit dhe ortakut)

ELIO DEVOLË


Z. Erti LIKAJ

(në cilësinë e ortakut)

Erti Likaj
